Gjetjet kryesore theksojnë katër dinamika thelbësore. Së pari, dezinformimi shfrytëzon brishtësinë e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë, duke gërryer besimin përmes amplifikimit të pakënaqësive historike dhe duke e paraqitur çdo incident të përditshëm si provokim etnik. Së dyti, ai instrumentalizohet nga elitat politike dhe aktorët e huaj, të cilët shfrytëzojnë polarizimin për të konsoliduar pushtetin ose për të avancuar agjenda gjeopolitike. Së treti, normalizimi i gjuhës së urrejtjes dhe narrativave të teorive të konspiracionit kontribuon në një klimë radikalizimi etno-politik, në të cilën retorika ekskluziviste dhe frika bëhen shoqërisht të pranueshme. Së fundmi, dezinformimi lulëzon në kushte të besimit të ulët në institucione. Ekspertët vunë në dukje se dezinformimi arrin kulmin rreth ngjarjeve të ngarkuara politikisht ose të lidhura me konfliktin, veçanërisht në veri të Kosovës, duke i transformuar incidentet e lokalizuara në kriza të perceptuara etnike. Ata gjithashtu përshkruan strategji asimetrike narrative që synojnë secilën komunitet ndryshe: serbët e Kosovës paraqiten si viktima të agresionit institucional, ndërsa shqiptarët e Kosovës paraqiten si të kërcënuar nga moskompromisi serb. Së fundi, një skepticizëm i thellë rreth kapaciteteve për zbutje pasqyron perceptimin se dezinformimi është

i rrënjësor në mënyrë strukturore në peizazhin politik dhe mediatik të Kosovës, duke u shërbyer aktorëve që kanë pak interes në ndërtimin e kohezionit shoqëror.

Të gjitha këto gjetje së bashku tregojnë për implikime serioze për stabilitetin dhe trajektoren politike të Kosovës. Dezinformimi jo vetëm që thëllon mosbesimin e ndërsjellë, por gjithashtu përgatit terrenin për radikalizim etno-politik, ku hendeku midis tensioneve latente dhe përballjes aktive ngushtohet. Duke minuar besimin publik, duke gërryer dialogun ndëretnik dhe duke forcuar sferat paralele të informacionit, dezinformimi paraqet një sfidë madhore për aspiratat e Kosovës për një shoqëri demokratike, multietnike dhe për integrimin e saj më të gjerë euro-atlantik.

Rezultatet e intervistave tregojnë një perceptim të përhapur mes ekspertëve se dezinformimi është një fenomen i shpeshtë dhe me ndikim në formësimin e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Shumica e të anketuarve raportuan se kanë hasur përmbajtje të rreme ose mashtruese të lidhura me marrëdhëniet etnike, me tetë nga dhjetë që u përgjigjën “po” kur u pyetën për ekspozimin personal ndaj dezinformimit. Ekspertët identifikuan kryesisht platformat e mediave sociale si Facebook, TikTok dhe X (Twitter), së bashku me aktorët politikë dhe mediat lokale, si burimet kryesore të dezinformimit. Sa i përket efekteve, pasojat më të cituara ishin rritja e mosbesimit midis grupeve etnike, gjuha e urrejtjes verbale ose online, dhe përhapja e narrativave konspirative, shpesh të lidhura me periudhat e tensioneve politike në veriun e Kosovës. Vlen të theksohet se shumica e të anketuarve u pajtuan ose u pajtuan fuqishëm se dezinformimi rrit drejtpërdrejt gjasat për tensione ose dhunë ndëretnike, dhe disa vunë në dukje se si komuniteti shqiptar e edhe ai serb në Kosovë janë të dyja në shënjestër, shpesh me narrativa që përforcojnë pakënaqësitë nga lufta e viteve 1990 ose e paraqesin komunitetin tjetër si kërcënim. Kjo tregon

se dezinformimi perceptohet jo si incidente të izoluar, por si një sfidë e vazhdueshme me efekte të prekshme mbi kohezionin shoqëror në Kosovë.

Dezinformimi shfrytëzon dinamikat e ndjeshme ndëretnike për të gërryer besimin midis komuniteteve në Kosovë. Ekspertët e intervistuar për këtë raport theksuan në mënyrë të vazhdueshme se dezinformimi në Kosovë lulëzon mbi brishtësinë e marrëdhënieve ndëretnike, duke shfrytëzuar narrativat kundërshtuese mbi të kaluarën për të dobësuar si besimin midis komuniteteve, ashtu edhe besimin brenda vetë komunitetit për të ardhmen e vendit. Ekspertët e intervistuar nënvizuan se si shqiptarët ashtu edhe serbët e Kosovës janë objekt i shënjestrës, por me narrativa të përshtatura sipas frikës ndaras për secilin grup. Për shembull, një pjesëmarrës vuri në dukje se dezinformimi "fajëson shqiptarët nëse është media me ndikim serb, dhe anasjelltas", duke krijuar një narrativë ciklike të kërcënimit dhe viktimizimit. Incidentet ilustruese përfshijnë videot e manipuluar të përlëshjeve fizike në veri dhe raportimet e ekzagjeruara për operacionet policore në veri të Kosovës, të cilat ekspertët besojnë se "provokojnë frikë dhe zemërim" dhe shpesh qarkullojnë në rrjete sociale përpara se të ndodhë ndonjë verifikim.

Kjo dezinformata nuk funksionon në izolim, por synon të përjetësojë dhe të i vazhdojë tensionet e pasluftës, ku kujtimet e luftës së viteve 1998–1999 dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme me Serbinë krijojnë një mjedis shumë të ndjeshëm për narrativa përçarëse. Efekti është normalizimi gradual i mosbesimit, pasi ekspertët kanë vërejtur se gjuha e urrejtjes në internet dhe incidentet e ekzagjeruara ndëretnike çojnë në "rritje të mosbesimit midis grupeve etnike" dhe pengojnë angazhimin e përditshëm ndëretnik. Me fjalë të tjera, dezinformimi e bën bashkëpunimin ndëretnik më toksik dhe më të vështirë në nivel komuniteti. Prandaj, dezinformimi nuk është thjesht një nënprodukt i mosmarrëveshjes Kosovë–Serbi, por një mekanizëm i qëllimshëm dhe efektiv për të mbajtur polarizimin në nivel shoqëror, gjë që e bën normalizimin e marrëdhënieve midis dy vendeve më të vështirë. Duke vepruar kështu, dezinformimi synon të ushqejë dhe të nxisë radikalizimin etno-politik, që do të thotë, të bindë serbët e Kosovës se qeverisë dhe institucioneve publike të Kosovës nuk mund të ju besohet ose pranohen kurrë, dhe se BE-ja dhe Perëndimi në përgjithësi nuk kanë interesin më të mirë për serbët e Kosovës. Ky lloj narrativash është i përhapur në fushatat e dezinformimit që synojnë marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë, dhe

sipas ekspertëve të intervistuar për këtë raport, janë kryesisht me origjinë të huaj.

Aktorët politikë dhe të huaj instrumentalizojnë me qëllim dezinformimin për të konsoliduar pushtetin. Ndërsa dezinformimi që synon të nxisë radikalizimin etno-politik në Kosovë është kryesisht me origjinë të huaj, ai përdoret gjithashtu gjerësisht edhe nga aktorët vendas për agjenda politike. Në këtë kontekst, tre fushata kryesore dezinformimi nga aktorët vendas në Kosovë kanë ndihmuar në ushqimin e radikalizimit etno-politik dhe të mosbesimit midis komuniteteve. Këto përfshijnë fushatën për të paraqitur procesin e decentralizimit në Kosovë, i cili u zbatu pas pavarësisë në 2008, si një ndarje të Kosovës; për të paraqitur Asociacionin/Bashkësinë e Komunave me Shumicë Serbe (AKS) si një tjetër "Republika Srpska", kryesisht nga viti 2013 e tutje; dhe fushatën për të parandaluar Kosovën të ratifikojë marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi në vitin 2016.

Të gjitha këto fushata shtrembëruan faktet dhe, përmes gjysmë të vërtetave, synuan të paraqisnin institucionet publike në Kosovë si të tilla që vepronin kundër interesave të vendit dhe si nënshkrues të verbër të vendimeve vetëm në interes të BE-së dhe SHBA-ve. Me fjalë të tjera, në këto fushata, BE-ja dhe SHBA-të paraqiteshin në mënyrë indirekte si aktorë që nuk kishin interesin më të mirë të Kosovës. Në përgjithësi, këto tre fushata arritën të gërryenin besimin shoqëror, të rrisnin skepticizmin ndaj dialogut për normalizim dhe ta polarizonin shumë shoqërinë. Ajo që bie në sy është se, në këto fushata, shpesh institutet kërkimore dhe organizatat e shoqërisë civile të financuara nga BE-ja morën pjesë në përhapjen e këtyre narrativave dhe kontribuuan në një kulturë të re politike që sheh jo vetëm marrëdhëniet me Serbinë si lojë të gjitha ose asgjë, por edhe marrëdhëniet me BE-në. Ky kuptim mbështetet gjithashtu nga intervistat tona me ekspertë, të cilët e shohin dezinformimin si një mjet të qëllimshëm dhe jo si një fenomen spontan.

"Narrativa dominante serbe pretendon se Kosova po përpiqet të i dëbojë serbët; ajo shqiptare thotë se veriu sundohet nga kriminelët." (V, 2 korrik 2025 – Intervistë me shkrim nga QKSS)

Ekspertët që intervistua shpesh e drejtojnë gishtin ndaj elitave politike dhe aktorëve të huaj si përfituesit dhe nxitësit kryesorë të fushatave të dizajnuara për të thelluar ndarjet etnike në Kosovë. Një i intervistuar tha troç se "elitave politike dhe aktorët e huaj, si

Serbia dhe Rusia, përfitojnë më së shumti," ndërsa një tjetër e përshkroi si një formë të "luftës hibride kundër Kosovës." Megjithatë, dezinformimi është bërë gjithashtu një instrument i luftës hibride kundër shoqërisë civile dhe mediave në Kosovë, të cilat sfidojnë status quo-n dhe qasjet e Kosovës ndaj komunitetit euro-atlantik. Narrativat e dezinformimit shpesh ndërthuren me momentet e tensionit politik, si zgjedhjet, apo momentet e përshkallëzimi në komunat e veriut të Kosovës, ose episodet e lidhura me dialogun për normalizim të lehtësuar nga BE-ja, duke amplifikuar agjendat politike. Për shembull, ekspertët kujtuan se si narrativa "Qeveria Kurti rreh njerëzit" në mediat serbe ose paraqitjet e serbëve si "bllokues të rrugëve" përdorej për të justifikuar pozicione antagoniste dhe për të mobilizuar ndjenjën publike. Aktorët e huaj, veçanërisht Rusia, synojnë të minojnë demokracinë e Kosovës dhe kursin e saj euro-atlantike, duke përdorur polarizimin etnik si një mjet për të dobësuar si legjitimitetin e shtetit, ashtu edhe besimin dhe mbështetjen për Kosovën nga komuniteti ndërkombëtar. Ndonjëherë, veprimet ose mosveprimet e qeverisë lehtësojnë në mënyrë të pavullnetshme këto narrativa. Me fjalë të tjera, ekziston një dinamikë që forcohet reciprokisht: aktorët politikë të Kosovës fitojnë legjitimitet afatshkurtër duke ushqyer frikën etnike, ndërsa fuqitë e jashtme shfrytëzojnë këtë paqëndrueshmëri për të arritur objektiva më të gjera gjeopolitike, duke thelluar më tej rreziqet e radikalizimit brenda strukturës politike dhe shoqërore të Kosovës.

"Kam hasur informacione të rreme dhe mashtruese, si dhe gjuhë urrejtjeje, kryesisht të lidhura me zhvillimet në komunat veriore të Kosovës. Për shembull, sa herë që ka pasur tensione ose rritje të dhunës në këtë pjesë të Kosovës, diskursi publik në hapësirën digjitale shqiptare dhe serbe shpesh përmban narrativa etno-nacionaliste, informacione të ofruara jashtë kontekstit për ngjarjet në vazhdim, tituj të ekzagjeruar dhe informacione të rreme."
(AB, 2 korrik 2025 – Intervistë me shkrim nga QKSS)

Dezinformimi nxit radikalizimin etno-politik në Kosovë duke normalizuar gjuhën e urrejtjes dhe narrativat konspirative. Intervistat me ekspertët tregojnë një model që tregon se dezinformimi kontribuon në radikalizimin gradual etno-politik. Ekziston një proces i qartë, ku ekspozimi i përsëritur ndaj narrativave

përçarëse, shpesh përmes platformave të mediave sociale, çon në normalizimin e gjuhës së urrejtjes, të të menduarit konspirativ dhe thirrjeve për politika përjashtuese ose etno-centrike. Ata që intervistuaam përmendën "mosbesimin në rritje midis grupeve etnike," "gjuhën e urrejtjes verbale ose online," dhe "përhapjen e teorive të konspiracionit" si efektet më të dukshme në nivel komuniteti të fushatave të dezinformimit. Një pjesëmarrës theksoi se hapësirat online janë të mbushura me "narrativa etnonacionale, informacione të ofruara jashtë kontekstit, tituj të ekzagjeruar dhe informacione të rreme," veçanërisht gjatë përshkallëzimeve në veri të Kosovës. Një përmbajtje e tillë krijon mjedise ku brezat e rinj trashëgojnë jo vetëm pakënaqësitë nga lufta brutale e viteve 1990, por edhe një narrativë të amplifikuar digjitale të kërcënimit dhe papajtueshmërisë. Në praktikë, kjo zvogëlon gatishmërinë për të marrë pjesë në aktivitete ndëretnike dhe, në disa raste, mund të çojë në justifikimin e veprimeve diskriminuese ose konfrontuese. Ndërsa pak ekspertë identifikuan lidhje direkte me dhunën fizike, ata gjithashtu vërejtën se ekspozimi i vazhdueshëm ndaj dezinformimit kultivon një klimë para-radikalizimi, ku frika, dyshimi dhe mllefi grumbullohen, duke e bërë bashkëpunimin ndëretnik gjithnjë e më të ndjeshëm drejt prishjes.

"Gjithçka mund të reduktohet në një ide të vetme: ne jemi të mirë, ata janë të këqij."
(Citat i parafrazuar nga intervistat me shkrim nga KCSS, 2 korrik 2025).

Kjo mendësi të gjitha ose asgjë është themeli i shumicës së narrativave etnike në Kosovë, duke nxitur një cikël fajësimi që nuk lë hapësirë për nuanca apo empati. Dezinformimi në Kosovë duket se lulëzon në një mjedis me besim të dobët institucional dhe mungesë të masave efektive institucionale dhe mediatike kundër dezinformimit. Dezinformimi në Kosovë fiton shumë ndikim për shkak të besimit të ulët të institucionet publike, dhe veçanërisht të sistemi gjyqësor, i cili mund të jetë një mundësi për disa që të trajtojnë rastet e dezinformimit. Ekspertët me të cilët biseduam argumentuan se kur kanalet zyrtare të informacionit perceptohen si të pasigurta ose të ngarkuara politikisht, qytetarët drejtohen te mediat sociale dhe mediat partiake, ku dezinformimi qarkullon me shpejtësi. Megjithatë, ekspertët tjerë kanë vërejtur se besimi nuk është një faktor shtytës që qytetarët të kthehen te mediat sociale për informacion, por kjo është bërë kultura e re informative, pasi edhe mediat gjithashtu gjithnjë e

më shumë po mbështeten në platformat e mediave sociale. Një ekspert, për shembull, vuri në dukje se “dezinformimi përhapet më lehtë për shkak të besimit të ulët të institucionet publike.” Në të njëjtën kohë, një tjetër sugjeroi se “shumë pak mund të bëhet në këtë lloj sistemi politik” pa një angazhim të besueshëm institucional me komunitetet jo-shumicë. Mungesa e përgjigjeve të koordinuara, si platformat shumëetnike të verifikimit të fakteve ose aktivitetet proaktive të komunikimit nga qeveria, lë hapësirë që aktorët vendas dhe të huaj të dominojnë narrativën. Masat e propozuara kundër dezinformimit nga ata me të cilët biseduam përfshijnë ekipe të komunikimit me reagim të shpejtë nga qeveria, rritjen e kapaciteteve të zyrave të komunikimit publik në institucionet publike, në mënyrë që të kenë kapacitetet me veprim në të dy gjuhët për të monitoruar dhe për të arritur të mediat shqipe dhe serbe në Kosovë. Sfidë në këtë kontekst lind kur vetë qeveria perceptohet si përhapëse e dezinformimit në lidhje me lajmet ose zhvillimet që lidhen me marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë. Pa masa për ndërtimin e besimit dhe përgjigje sistematike, edhe incidentet më të vogla mund të amplifikohen në kriza mes komuniteteve, gjë që përforcon më tej ciklin e dezinformimit dhe polarizimit.

“Kam parë e dëgjuar rrëfime të rreme që pretendonin se grupe të caktuara etnike (nëse janë media të ndikuara nga serbet, atëherë fajësojnë shqiptarët dhe anasjelltas) po planifikonin veprime të dhunshme, ose se vendet kulturore ose fetare u shkatërruan nga një komunitet tjetër. Këto rrëfime janë të sajura ose ndonjëherë të ekzagjeruara për të provokuar frikë dhe zemërim.” (Citat nga K - 2 korrik 2025 – Intervistë me shkrim nga QKSS)

Dezinformimi në lidhje me marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë shpesh është i nxitur nga ngjarjet, duke u përqendruar në incidente politikisht të ndjeshme ose tensione të lokalizuara. Ekspertët iu referuan episodeve në veri të Kosovës, të tilla si konfrontimet me policinë, vendosja e barrikadave ose festimet simbolike të komunitetit, të tilla si festa e maturës e shkollave të mesme. Në muajin maj të vitit 2025, maturantët e shkollave të mesme festuan në veri të Kosovës me brohoritje se “Kosova është zemra e Serbisë”³⁶, duke çuar në incidente sigurie të tilla si rasti

i oficerit të Policisë së Kosovës që kapi një maturant për qafë në Mitrovicën Veriore.³⁷ Këto përfshijnë rastet kur narrativat e dezinformimit përhapen shpejt. Një anëtar i shoqërisë civile me të cilin biseduam përshkroi se “madje edhe platformat e besueshme si Telegrafi.com kishte përhapur pak dezinformim” kur raportonin për festën e maturës së shkollave të mesme në Mitrovicën Veriore që çuan në ndërhyrje policore. Ngjarje të tilla, si matura në Mitrovicën Veriore, ofrojnë terren të përshtatshëm për krijimin e narrativave shumë emotive, shpesh të paraqitura në terma “krejt ose asgjë” që portretizojnë një komunitet si agresor dhe tjetrin si viktimë. Rritjet e dezinformimit rrallë janë spontane, por amplifikohen qëllimisht në hapësirat digjitale për të shfrytëzuar vëmendjen publike, duke krijuar perceptimin e krizave në përshkallëzim edhe kur incidentet janë të lokalizuara. Me fjalë të tjera, dezinformimi në Kosovë funksionon si një përshpejtuese e tensionit etnik, duke i kthyer ngjarjet rutinore ose të izoluar në nxitës për polarizim më të gjerë.

“Midis serbëve, ekziston besim i verbër në versionin e ngjarjeve që e transmeton Beogradi. Midis shqiptarëve, ekziston një kujtesë e patundur e luftës.” (Citim i parafrazuar nga intervistat me shkrim nga QKSS, 2 korrik 2025)

Narrativat dezinformuese në Kosovë janë asimetrike dhe të drejtuara drejt një audience specifike. Ndërsa disa ekspertë theksuan se dezinformimi “i shënjestron të dy komunitetet në mënyrë të barabartë”, përshkrimet e tyre të detajuara zbulojnë një qasje asimetrike narrative. Tek serbët e Kosovës, dezinformimi zakonisht fokusohet në viktimizim dhe kërcënim të jashtëm, duke e portretizuar “qeverinë Kurti” dhe institucionet e Kosovës si represive ose të rrezikshme. Për shqiptarët e Kosovës, narrativat kanë tendencë të evokojnë frikë nga siguria dhe kujtesë nacionaliste, duke përfshirë pretendimet se serbët e Kosovës në veri po planifikojnë veprime të dhunshme ose po pengojnë shtetin. Një ekspert vuri në dukje se midis serbëve të Kosovës ekziston një “besim i

provokime që rrezikojnë rendin dhe sigurinë”, <https://www.telegrafi.com/en/Serbian-high-school-graduation-pa-rade-in-northern-Sweden-does-not-allow-provocations-that-endanger-order-and-security/?noamp=mobile>

37 KosSev.info “Pse një oficer policie e kapi për qafë një maturant në veri të Mitrovicës?”, <https://kossev.info/kosovo-latest-news-why-did-a-police-officer-grab-a-graduate-by-the-neck-in-north-mitrovica/>

36 Telegrafi.com “Parakalimi i maturantëve të shkollave të mesme në gjuhën serbe në veri, Sveçla: Kosova nuk lejon

verbër i narrativës ... se Kosova dëshiron të dëbojë të gjithë serbët nga vendi”, ndërsa midis shqiptarëve të Kosovës dezinformimi shpesh “ekzagjeron kujtimet e luftës së vitit 1999” për të ruajtur dyshimin ndaj serbëve në përgjithësi. Ky dualitet ilustron strategjinë e sofistikuar të pasqyrës, ku çdo komunitet e merr dezinformim që konfirmon ndjenjën e tij paraprake të padrejtësisë dhe mosbesimit. Duke përforcuar perceptimet paralele, por të kundërta, të kërcënimit, dezinformimi asimetrik priret të thellojë ose të përkeqësojë ndarjen, apo ndarjen e ndërsjellë, gjë që e bën shumë të vështirë komunikimin ndër-etnik dhe i bën narrativat radikale më të pranueshme shoqërisht për secilën audiencë.

“Narrativat kryesore që kam parë të

përdoren më shpesh për të rritur tensionet midis shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve janë: Të rinjtë serb të Kosovës perceptohen si të pandryshueshëm nga brezat e vjetër që luftuan në luftë dhe kryen dhunë kundër komunitetit shqiptar – dhe i njëjti perceptim ekziston edhe në anën tjetër. Besohet se të rinjtë shqiptarë të Kosovës nuk kanë dëshirë të bashkëtojnë me serbët në asnjë rrethanë – dhe anasjelltas. Çdo miqësi e mundshme midis të rinjve serb dhe të rinjve shqiptarë shihet si e rrezikshme – si në aspektin e sigurisë fizike ashtu edhe sepse konsiderohet si një akt “tradhtie”. (Koala, 2 korrik 2025 - Intervistë me shkrim nga QKSS)




FIGURA 1: Dezinformimi → Rrjedha e Radikalizimit Etno-Politik

4. Burimet e dezinformimit në Kosovë që synojnë të nxisin tensionet etnike

Gjatë viteve të fundit, veçanërisht pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia në vitin 2022, marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë janë bërë një objekt kryesor për grupet e organizuara në sferën digjitale, me fokus të veçantë te komuniteti serb në Kosovë. Këto marrëdhënie janë tensionuar nga një sërë ngjarjesh që kanë krijuar një klimë të vazhdueshme tensioni politik. Vendimi i qeverisë së Kosovës për të zbatuar masa reciprociteti për mallrat dhe targarat e automjeteve me Serbinë në vitin 2022, nxiti një varg ngjarjesh që kulmuan me dorëheqjen e koordinuar të punonjësve serbë nga institucionet publike po atë vit, si formë proteste ndaj vendimeve të qeverisë — duke lënë boshllëqe të mëdha në administratë dhe duke nxitur një narrativë të përndjekjes së komunitetit serb nga qeveria e Kosovës.

Tensionet u përshkallëzuan edhe më tej në prill të vitit 2023, kur komuniteti serb bojkotoi zgjedhjet e parakohshme lokale, gjë që rezultoi me emërimin e kryetarëve jo-serbë në komunat me shumicë serbe. Kjo shkaktoi protesta të dhunshme dhe përplasje me forcat ndërkombëtare të KFOR-it. Sulmi i armatosur në Banjskë në shtator 2023, ndalimi i përdorimit të dinarit serb në shkurt 2024 dhe mbyllja e strukturave paralele serbe e thelluan krizën. Të gjitha këto ngjarje janë shoqëruar me cikle të vazhdueshme narrativesh dezinformuese, të cilat, përmes platformave si Telegram, mediave proqeveritare serbe dhe aktorëve politikë, kanë përforcuar një kornizë të vazhdueshme të viktimizimit dhe përjashtimit serb në Kosovë.

Këto zhvillime e kanë dobësuar ndjeshëm perceptimin e sigurisë në vend nga komuniteti serb. Sipas Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, anketa "Pulsi Publik"³⁸ — Këto zhvillime e kanë dobësuar ndjeshëm perceptimin e sigurisë në vend nga komuniteti serb. Sipas Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, anketa "Pulsi Publik" — një sondazh gjashtëmujor që trajton çështje socio-ekonomike, politike, të sigurisë dhe mjedisit — ka treguar një rënie të vazhdueshme në ndjenjën e sigurisë te qytetarët

serbë që nga nëntori i vitit 2022. Në publikimin më të fundit (korrik 2024), ky perceptim ka rënë për 5.7 përqindj krahasuar me nëntorin 2023, duke arritur në 31.9%.

Ndjenja e perceptuar e sigurisë filloi të përkeqësohej dukshëm gjatë vitit 2022. Në gjysmën e dytë të atij viti, vetëm 15.3% e serbëve të Kosovës të anketuar raportuan se ndiheshin të sigurt — një rënie drastike krahasuar me 46.1% vetëm gjashtë muaj më parë. Kjo rënie e ndjeshme përkoi me një valë tensionesh politike dhe protestash në veri të Kosovës, përfshirë bllokadat rrugore të organizuara nga komuniteti serb. Kulmi u arrit në nëntor, kur partia më e madhe e serbëve në Kosovë, Lista Srpska, njoftoi tërheqjen e saj nga institucionet publike dhe komunat në veri.

Tensionet e përshkallëzuara gjatë katër viteve të fundit kanë prodhuar efekte në dy drejtime kryesore. Së pari, ato janë amplifikuar në mënyrë selektive për të nxitur dezinformata dhe narrativa njëanshme që e paraqesin qeverinë e Kosovës si një aktor që synon të përndjekë dhe të i dëbojë serbët duke shtypur të drejtat e tyre. Këto narrativa kanë synuar kryesisht komunitetin serb në Kosovë, ndërsa gjithashtu kanë pasur për qëllim të ndikojnë opinionin publik ndërkombëtar. Së dyti, ato janë instrumentalizuar për të delegjitimuar çdo kritikë nga komuniteti serb ndaj veprimeve të qeverisë së Kosovës.

Ndërkohë, megjithëse këto narrativa nuk e synojnë drejtpërdrejt komunitetin shqiptar, perceptimi i tij për situatën formohet kryesisht nga mediat në gjuhën shqipe në Kosovë. Këto media priren të përqendrohen te komuniteti serb kryesisht gjatë momenteve të tensioneve të larta etnike, shpesh duke përfituar nga ndjeshmëria emocionale e komunitetit shqiptar. Mbulesa mediatike është zakonisht e fragmentuar, i mungon vazhdimësia, dhe e paraqitur në forma të njohura që rezonojnë me audiencën e tyre. Si rezultat, kjo përforcon këndvështrim të njëanshëm mbi realitetin në veriun e Kosovës dhe rralëherë ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të bashkëjetesës ndëretnike apo përvojave të përbashkëta të përditshme. Në momentet e tensioneve të shtuara etnike, disa gazetarë shqiptarë lejojnë që emocionet të ndikojnë në raportimin e tyre, duke kompromentuar objektivitetin dhe paanshmërinë që janë thelbësore

38 UNDP Kosovë, "Përmbledhje e Pulsit Publik XXVI" https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/2024-07/Pulse%20Pulse_Shqip_final1.pdf

për informimin e publikut pa nxitur konflikte të mëtejshme.

Midis qindra kompanive mediatike shqip që operojnë në Kosovë, vetëm disa nga më të lexuarat — përveç transmetuesit publik RTK — e ofrojnë përmbajtjen e tyre edhe në gjuhën serbe. Kosovo 2.0 është e vetmja media që ofron gazetari në gjuhën serbe, ndërsa Radio Evropa e Lirë është e vetmja organizatë mediatike që mbulon në mënyrë të vazhdueshme komunat me shumicë serbe. Historitë e bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve mbeten të rralla dhe zakonisht paraqiten si përjashtime, e jo si pjesë e jetës së përditshme.

Të dyja këto fenomene — narrativat dezinformuese të përhapura përmes kanaleve specifike dhe paafësia për të ofruar një pasqyrë të balancuar, të paanshme dhe gjithëpërfshirëse në hapësirën publike shqiptare — kontribuojnë në pezullimin dhe shpesh në nxitjen e tensioneve etnike. Ato pengojnë përparimin dhe përpjekjet për afrimin ndëretnik. Kjo bëhet veçanërisht e rrezikshme në kohë tensionesh të shtuara në komunat me shumicë serbe, kur të dy komunitetet, shqiptarë dhe serbë, informohen përmes narrativave të ndara, emocionalisht të ngarkuara dhe të përgatitura paraprakisht.

Dezinformimi që buron nga mediat serbe pro-qeveritare është hulumtuar gjerësisht. Këto media vazhdimisht promovojnë narrativa që i portretizojnë institucionet e Kosovës si të paligjshme dhe armiqësore, ndërkohë që përforcojnë qëndrimin politik të Beogradit. Ky mjedis mediatik ofron pak hapësirë për perspektiva alternative dhe kontribuon në një diskurs publik thellësisht të polarizuar.

Shumë anëtarë të komunitetit serb në Kosovë mbështeten te transmetuesit serb, përfshirë TV Pink, Informer dhe Kurir — të cilët të gjithë konsiderohen pro-qeveritarë — dhe që janë të disponueshëm përmes të gjitha operatorëve kabllorë në zonat me shumicë serbe.

Një narrativë e përsëritur në këto media pretendon se mbi serbët në Kosovë po ushtrohet "terrori", se institucioneve të Kosovës nuk kanë legjitimitet dhe se bashkësia ndërkombëtare po kryen "padrejtësi." Në të njëjtën kohë, Lista Srpska paraqitet si e vetmja përfaqësuese legjitime e serbëve të Kosovës. Zërat alternativë — qoftë nga institucionet e Kosovës apo nga politikanë serbë që nuk janë të përafuar me Beogradin — rrallë, nëse ndonjëherë, paraqiten dhe shpesh etiketohen si "tradhtarë." Narrativa dominuese pasqyron në mënyrë të strikte qëndrimin e Beogradit dhe promovon në mënyrë të qartë Lista Srpska. Kjo

lloj përmbajtjeje nxit mosbesim të gjerë tek serbët e Kosovës, veçanërisht ndaj institucioneve të Kosovës.

Përveç mediave serbe, edhe mediumet ruse si Sputnik Srbija dhe RT Balkan (ish Russia Today) luajnë gjithashtu një rol në përhapjen e dezinformatave. Megjithëse këto media janë të sanksionuara në Kosovë dhe nuk janë të disponueshme përmes televizionit, faqet e tyre të internetit mbeten të aksesueshme herë pas here përmes ofruesve të internetit mobil si Vala, IPKO dhe MTS. Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare i Kosovës (ARKEP) ka urdhëzuar të gjithë ofruesit e internetit të bllokojnë këto faqe në përputhje me sanksionet. Megjithatë, natyra e lëvizshme e aksesit online bën që zbatimi i ligjit mund të ndryshojë.

Sipas Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të BE-së, RT Balkan dhe Sputnik publikuan rreth 60 artikuj lidhur me zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës në shkurt 2025. Ndërsa disa prej tyre përfshinin narrativa manipuluese që shënjestronin komunitetin serb, shtrirja e tyre e përgjithshme në rrjetet sociale ishte e kufizuar, me përmbajtje të postuara vetëm në X (ish-Twitter) dhe rrallë arritnin më shumë se 2,000 shikime.

Ndërsa mediat serbe pro-qeveritare janë identifikuar prej kohësh si burime kryesore të dezinformatave, rrjetet e organizuara të dezinformatave që veprojnë në sferën digjitale — veçanërisht në Telegram — kanë filluar së fundmi të vihen nën vëzhgim.

Këto rrjete, të cilat mbledhin mijëra individë me qëndrime të forta nacionaliste pro-serbe dhe pro-ruse, përfaqësojnë një vazhdimësi të narrativave të vjetra të dezinformatave, por brenda një mjedisi të pa rregulluar. Rreziku qëndron në faktin se ato operojnë në një platformë pa moderim, që lejon anonimitet të plotë, duke krijuar terren të favorshëm për përhapjen e urrejtjes dhe dezinformatave. Përveç mediave tradicionale dhe atyre sociale si burime të dezinformatave dhe tensioneve ndër-etnike, udhëheqësit politikë në Kosovë dhe Serbi vazhdojnë të luajnë një rol qendror në nxitjen e ndarjeve përmes retorikës nxitëse dhe narrativave selektive. Zyrtarë të lartë, përfshirë anëtarë të Listës Srpska, shpesh përshkruajnë veprimet e qeverisë së Kosovës si "terror", "pastrim etnik" ose "persekutim" të komunitetit serb. Kjo gjuhë, e pasqyruar nga mediat serbe pro-qeveritare, forcon frikën dhe mosbesimin, duke lënë pak hapësirë për perspektiva alternative ose dialog konstruktiv.

Nga ana tjetër, reagimet institucionale të Kosovës ndaj incidenteve ndëretnike shpesh duken të paqëndrueshme. Incidentet kundër të kthyerve

serbë në jug të lumit Ibër shpesh nuk trajtohen, duke mos marrë as dënim publik nga institucionet dhe as mbulim në mediat në gjuhën shqipe. Kjo mungesë e reagimit të qëndrueshëm, së bashku me mungesën e përpjekjeve politike për të nxitur bashkëjetesën, kontribuon në perceptimet e njëanshmërisë institucionale, thellon polarizimin dhe i mundëson dezinformatave të lulëzojnë. Për më tepër, institucionet e Kosovës shpesh marrin vendime që ndikojnë në komunitetin serb të Kosovës pa u angazhuar në një dialog kuptimplotë ose komunikim të qartë. Këto veprime shpesh paraqiten si një "shtrirje e sovranitetit," që, megjithëse e bazuar ligjërish, perceptohet gjerësisht nga serbët e Kosovës si e njëanshme dhe provokuese. Etiketimi i shumë incidenteve në veri si "ngjarje të inskenuara" të orkestruara nga Beogradi e heq më tej komunitetin lokal serb nga veprimi, duke përforduar portretizimin e tyre si instrumente të thjeshta të ndikimit të jashtëm dhe duke amplifikuar ndjenjat e margjinalizimit dhe mosbesimit.

Kjo pjesë ka për qëllim të analizojë se si tensionet ndër-etnike në Kosovë po instrumentalizohen nga rrjete të koordinuara dezinformimi — kryesisht me

origjinë nga Serbia — përmes kanaleve në Telegram, mediave lokale pro-serbe dhe fushatave më të gjera propagandistike ruse. Njëkohësisht, shqyrton se si diskursi publik në disa media në gjuhën shqipe mund, ndonjëherë pa dashje, të kontribuojë në forcimin e polarizimit ndër-etnik. Duke analizuar të dyja anët e këtij ekosistemi informacioni — nga burimet e organizuara të propagandës deri te mbulimi i fragmentuar mediatik — raporti synon të ofrojë një pasqyrë të ekuilibruar se si ndërtohen dhe shpërndahen narrativat, duke ndikuar në marrëdhëniet ndër-etnike brenda vendit. Kjo nuk është një analizë e plotë e të gjitha formave të dezinformimit ose e çdo aktori që vepron në këtë hapësirë. Shtrirja është qëllimisht e kufizuar: për të ilustruar rreziqet që lindin nga qarkullimi i narrativave që nxisin tensione ndër-etnike përmes një përzgjedhjeje rastesh përfaqësuese. Përfshirja e raporteve të disa mediave në gjuhën shqipe nuk ka për qëllim të barazojë gazetarinë lokale me propagandën, por të theksojë se edhe mënyra se si diskursi institucional dhe mediatik i adreson këto realitete mund, pa dashje, të kontribuojë në thellimin e ndarjeve ekzistuese




FIGURA 2: Cikli i Dezinformimit dhe Polarizimit

4.1 Dezinformimi që shënjestron komunitetin shqiptar

Pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia, kanalet në Telegram të fokusuar te Kosova u shumuan³⁹, dhe audiencat e tyre u rrit ndjeshëm gjatë viteve 2021–2024. Platforma Telegram po bëhet gjithnjë e më shumë një hapësirë e favorshme për përhapjen e narrativave nacionaliste pro-ruse dhe pro-serbe, me çështjen e Kosovës në qendër të mobilizimit. Në një mjedis të pamoderuar, pa mekanizma kontrolli për përmbajtjen, janë shfaqur dhjetëra kanale që promovojnë retorikë radikale — nga mohimi i shtetësisë së Kosovës deri te thirrjet për ndërhyrje ushtarake.

Megjithëse shumica e këtyre grupeve nuk kanë një prezencë fizike të organizuar në Kosovë, ato shfrytëzojnë çdo zhvillim lokal për të forcuar mesazhet e tyre nacionaliste dhe për të mobilizuar ndjekësit, si brenda, ashtu edhe jashtë Serbisë. Rritja e tyre lidhet ngushtë me krizën e vazhdueshme në veri të Kosovës, ku përplasjet midis institucioneve të Kosovës dhe komunitetit serb kanë shërbyer si terren i përshtatshëm për propagandë dhe frikësim.

Përmes përmbajtjes së përditshme, ata përziejnë informacione të pasakta, teori konspirative dhe gjuhë urrejtjeje, duke krijuar një realitet paralel që i largon

ndjekësit nga faktet dhe i shtyn drejt radikalizimit ideologjik dhe politik.

Duke u pozicionuar si hapësira “pa censurë”, këto kanale ndërtojnë identitetin e tyre rreth narrativave mitike dhe emocionale. Çdo ditë, ato publikojnë përmbajtje që sillen rreth temave të filla si lidhja shpirtërore me Kosovën — e përshkruar si një lidhje e shenjtë me parajsën — thirrjet për rikthimin e ushtrisë serbe në Kosovë, dhe pretendimet për “persekutim” të serbëve nga “terroristët shqiptarë.” Në këtë mënyrë, këto kanale nuk janë thjesht mjete komunikimi, por platforma për ndërtimin e një identiteti kolektiv ekstremist që thëllon ndarjet etnike dhe minon përpjekjet për normalizim..

Aktiviteti i këtyre kanaleve intensifikohet sa herë që shpërthejnë kriza politike në komunat me shumicë serbe në Kosovë. Megjithëse shumica e këtyre kanaleve — përfshirë BUNT, Bunker, Koridor dhe Srpska Sparta Info — tani mbulojnë një gamë të gjerë temash bazuar në zhvillimet gjeopolitike në rajon dhe më gjerë (p.sh., në Serbi, Bosnje e Hercegovinë, Rusi, Ukrainë), Kosova mbetet një nga temat më të përdorura për mobilizim.

Në këtë kontekst, kanalet e fokusuar në Kosovë prodhojnë përmbajtje që më pas ripërdoret dhe ripostohet nga kanale më të mëdha, duke përforcuar vazhdimisht narrativën përmes qarkullimit ndërmjet kanaleve. Kosova shërben jo vetëm si një temë mobilizuese gjatë kohërave të krizës, por edhe si një simbol kyç në ndërtimin e një identiteti nationalist dhe revizionist që jehon përtej kufijve të vendit.

³⁹ Gentiana Paçarizi dhe Uran Haxha, Qendra Kundër Dezinformimit e Ballkanit Perëndimor, <https://hibrid.info/telegrami-parajsa-e-kanaleve-pro-ruse-tema-e-kosoves-mobilizon-nacionalistet-serbe-pro-ruse/>

Kanali	Anëtarët (Korrik 2025)	Anëtarët (Gusht) 2024
Bunt je stanje duha	86,566	86,466
BunkerSrb	23,056	17,023
Koridori	10,561	7,114
Srpska Sparta Info	14,599	13,642

FIGURA 3: Kanalet e Telegramit dhe anëtarësimi i tyre në vitet 2024–2025

Nga përmbajtja e publikuar në këto kanale, duket se një pjesë e madhe e materialit prodhohet në vendngjarje nga qytetarë vendas serbë të Kosovës — një element që sugjeron përfshirjen e tyre aktive në këto rrjete të organizuara digjitale. Përmbajtja është e mbushur me glorifikim të dhunës, mbështetje për luftën e Rusisë në Ukrainë dhe mesazhe që nxisin urrejtje ndaj shqiptarëve dhe Perëndimit. Një nga sloganet më të përdorura nga kanali BUNT është: “Gjithçka është Rusia, përveç Kosovës. Kosova është Serbi” — një shprehje që përmbledh bashkimin e ideologjisë pro-ruse me nacionalizmin ekstrem serb.

Kjo propagandë nuk shërben thjesht si një mjet për të justifikuar refuzimin e realitetit politik të Kosovës; ajo funksionon si një mekanizëm i fuqishëm për mobilizim emocional dhe ideologjik. Ajo përforcon ndarjet ekzistuese dhe radikalizon audiencat përmes gjuhës që idealizon dhunën dhe legjitimon rezistencën ndaj çdo forme të integritetit institucional.

Përtej aktivitetit online, ndikimi i këtyre kanaleve është i dukshëm edhe në botën reale. Këto kanale janë bërë mjete të fuqishme për mobilizimin e protestave, bllokimeve të kufijve dhe veprimeve të tjera destabilizuese. Ato kanë organizuar ose mbështetur thirrje për protesta në Beograd, grafite nacionaliste që lavdërojnë sulmin në Banjska, dhe mobilizim fizik në veri të Kosovës. Kjo tregon se Telegram nuk është më vetëm një hapësirë për diskurs ekstremist — por është bërë një platformë organizative për aktorë që synojnë të sfidojnë rendin kushtetues dhe stabilitetin rajonal. Linja midis botës digjitale dhe asaj reale po zbehet, duke kthyer propagandën në Telegram në një mjet konkret destabilizues politik dhe shoqëror.

Një nga narrativat më këmbëngulëse dhe të përsëritura nga këto kanale është pretendimi se populli serb në Kosovë është i pambrojtur dhe nën persekutim të vazhdueshëm nga institucionet e Kosovës. Ky diskurs synon të delegitimojë institucionet shtetërore të Kosovës dhe përputhet me retorikën zyrtare të qeverisë së Serbisë, e cila vazhdon t’i referohet institucioneve të Kosovës si “të përkohshme” ose “të ashtuquajtura.” Çdo zhvillim në komunitat me shumicë serbe — qoftë masë administrative apo vendim gjyqësor — paraqitet si pjesë e një zinxhiri persekutimi kundër popullsisë serbe.

Një karakteristikë veçanërisht tronditëse e këtyre narrativave është mungesa e shpeshtë e burimeve të besueshme dhe mohimi i çdo informacioni alternativ. Anëtarët dhe administratorët e kanaleve paraqiten si burime “të vërteta” dhe “pa censuruar”, duke

ndërtuar një logjikë binare sipas së cilës i gjithë informacioni nga mediat profesionale ose institucionet e Kosovës konsiderohet i manipuluar ose i rremë.

Një veçori tjetër dalluese është mobilizimi përmes narrativave emocionale dhe të shenjtë. Përmbajtja që lidhet me zhvillimet në komunitat me shumicë serbe zakonisht paraqitet pa kontekst, në mënyrë të fragmentuar dhe shumë emocionale. Postimet janë të shkurtra, shpesh të shoqëruara me imazhe ose slogane dramatike, dhe një ngjarje e vetme — pavarësisht rëndësisë së saj reale — trajtohet për ditë të tëra si një incident mobilizues. Në këtë mënyrë, çdo episod portretizohet si një dëshmi tjetër e padrejtësive që gjoja përjetohen nga serbët e Kosovës nga duart e qeverisë “represive”.

Narrativa ndjek një model të dallueshëm dhe të përsëritur, në të cilin çdo zhvillim përshkruhet përmes elementëve të mëposhtme:

- **Padrejtësia historike e kryer kundër popullit serb;**
- **Viktimizimi kolektiv si një popullsi e persekutuar në tokën e vet;**
- **Lidhja shpirtërore me Kosovën, e portretizuar si tokë e shenjtë serbe;**
- **Tradhtia ose pafuqia e qeverisë serbe;**
- **Heroizmi i serbëve lokalë, shpesh i mitizuar përmes simboleve fetare dhe të shenjtë të rezistencës.**

Ky model emocional dhe simbolik nuk ka për qëllim të informojë, por të mobilizojë — duke e shndërruar çdo zhvillim lokal në një kauzë ekzistenciale që kërkon veprim, besim dhe besnikëri ideologjike.

Një tjetër veçori e theksuar e këtyre rrjeteve është funksionimi i tyre si një ekosistem i ndërlidhur, ku përmbajtja amplifikohet në mënyrë të ndërsjellë. Shumë nga këto kanale veprojnë si pjesë e një rrjeti të strukturuar dhe së fundmi kanë filluar të promovojnë një listë të përbashkët kanalesh, të cilën e paraqesin si Rrjeti Informativ Serb.

Në një postim të shpërndarë gjerësisht, thuhet:

“Jemi bashkuar për t’ju sjellë, në një vend, burimet më të besueshme të informacionit, analizave dhe komenteve nga fusha të ndryshme. Ndiqni kanalet nga lista dhe bëhuni pjesë e një rrjeti që nuk varet nga censura.”

Kjo listë përfshin kanale të tilla si Bunker, Webtribune, Ukr Leaks_srb, Republika Srpska, Infodefenseserbia, Srpski Glasnik dhe Republika Srpska Army. Kjo nismë për të centralizuar burimet e dezinformimit jo vetëm që rrit shtrirjen dhe ndikimin e secilit kanal individual, por gjithashtu synon të ndërtojë një burim paralel informacioni, të ndarë nga media tradicionale dhe të ndërtuar mbi një logjikë të radikalizimit të qëndrueshëm.

Këto kanale nuk kufizohen vetëm në narrativat rreth Kosovës. Ato përhapin gjithashtu mesazhe të forta anti-perëndimore. NATO, BE dhe SHBA-të portretizohen vazhdimisht si kërcënime, ndërsa integrimi euroatlantik përshkruhet si një akt dorëzimi ose tradhtie kombëtare.

Në këtë kontekst, Telegram shërben si një "strehë e sigurt" për këto narrativa, duke u ofruar atyre një hapësirë pa asnjë kontroll institucional apo editorial. Ajo që do të ishte e papranueshme në mediat tradicionale ose e censuruar nga platformat kryesore sociale, këtu jo vetëm që lejohet, por gjithashtu promovohet dhe përhapet shpejt dhe pa pengesa. Në këtë mënyrë, Telegram po konsolidon veten si një mjet kyç për amplifikimin e propagandës anti-Perëndimore dhe forcimin e boshtit strategjik midis nacionalizmit serb dhe interesave ruse në Ballkan.

Pavarësisht pranisë së spikatur të këtyre kanaleve dhe rritjes së tyre në hapësirën digjitale, mund të thuhet më shumë për qëllimet që ato përfaqësojnë sesa për ndikimin e tyre aktual mbi komunitetin serb në Kosovë. Deri tani, nuk ekziston ndonjë hulumtim i thelluar që hedh dritë mbi shkallën e ekspozimit të qytetarëve serbë ndaj këtyre kanaleve, përfshirjen e tyre aktive si ndjekës ose kontribuues, apo perceptimet e tyre për përmbajtjen që qarkullon brenda tyre. Ky mungesë e të dhënave empirike e bën të vështirë vlerësimin e ndikimit konkret që këto rrjete kanë mbi bindjet, qëndrimet politike ose ndjenjën e sigurisë midis komunitetit serb në Kosovë. Si rezultat, shumica e analizave aktuale — përfshirë edhe këtë — përqendrohen më shumë te strukturat, narrativat dhe mekanizmat e shpërndarjes sesa te efektet e tyre të drejtpërdrejta sociale dhe kulturore.

Ndërsa kanalet e dezinformimit në Telegram janë vënë gjithnjë e më shumë nën monitorim nga gazetarët dhe verifikuesit e fakteve në Kosovë dhe rajon, një burim tjetër i fuqishëm i dezinformimit mbetet kryesisht i paadresuar⁴⁰ — pavarësisht se është

shumë më publik dhe i qasshëm sesa platformat e mbyllura: Kosova Online, një medium me seli në Zveçan, e cila vepron si pjesë e një ekosistemi më të gjerë mediatik që amplifikon narrativat destabilizuese kundër institucioneve të Kosovës.

Ndryshe nga Telegrami, i cili funksionon në mënyrë të fragmentuar dhe gjysmë-anonime, Kosova Online ka një prani të strukturuar, akses të rregullt në hapësirën publike dhe përdor gjuhën e gazetarisë "zyrtare" për të përhapur dezinformata — shpesh duke cituar burime të anshme, duke shtrembëruar fakte, ose duke futur konotacione politikisht destabilizuese në raportimin e saj.

"Kosova Online" mbulon zhvillimet në Kosovë, veçanërisht në komunat me shumicë serbe. Përmbajtja e saj publikohet në tre gjuhë - kryesisht në serbisht, me disa artikuj të përkthyer në shqip dhe anglisht. Kjo shumë gjuhësi i jep medias pamjen e të qenit e balancuar dhe e orientuar ndërkombëtarisht, por në thelb, ajo shërben për të amplifikuar një narrativë të njëanshme.

Sipas Monitorit të Pronësisë së Medias 2023,⁴¹ ky medium u regjistrua në vitin 2019 në Zveçan nën kompaninë "VIM INFO" D.O.O., e cila zotërohet nga Dušan Milanović. Në Serbi, kjo kompani figuron si pjesë e AVALA MEDIA GROUP DOO BELGRADE, e drejtuar nga Ivan Jakšić — ish-këshilltar për komunikim në Zyrën për Kosovën të Serbisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme. Jakšić shërben gjithashtu si drejtor dhe redaktor kryesor i Kosova Online. Në Kosovë, koordinatori për katër komunat me shumicë serbe është Ivica Simić, vëllai i Igor Simić, ish-nënkryetar i Lista Srpsës partia politike më e madhe e serbëve të Kosovës dhe e lidhur ngushtë me Beogradin zyrtar.

Edhe pse prezantohet si një medium profesional, nga struktura e pronësisë deri te përmbajtja redaktoriale, Kosova Online funksionon si një dorë e zgjatur e aparatit propagandistik të qeverisë serbe. Artikujt, intervistat dhe karikaturat redaktoriale shpesh përmbajnë dezinformata, paraqesin një realitet të shtrembëruar të situatës në Kosovë dhe përforcojnë narrativat që përputhen me qëndrimin zyrtar të Beogradit. Për më tepër, prania publike e medias

shor 22, 2024, <https://hibrid.info/kosovo-online-dhe-qeveria-serbe-nje-aleance-dezinformatash/>

41 Monitori i Pronësisë së Medias në Kosovë (2023), "Kosova Online", BIRN, që jep detaje mbi pronësinë dhe strukturën e portalit, <https://kosovo.mom-gmr.org/en/media/detail/outlet/kosovo-online-1/>

40 Gentiana Paçarizi dhe Uran Haxha, Kosova Online dhe Qeveria Serbe: Një aleancë dezinformatash, Hibrid, qer-

dhe legjitimiteti institucional e bëjnë atë edhe më të rrezikshme se rrjetet e mbyllura në Telegram, pasi dezinformata është paketuar në formën e lajmeve profesionale dhe përhapet përtej kufijve etnikë dhe gjeografikë.

Qëndrimi editorial i Kosovo Online bëhet veçanërisht i dukshëm në seksione të caktuara të faqes së saj të internetit, siç janë “Analiza” dhe “Konteksti”. Këto kategori mbulojnë tema të ndryshme që lidhen me zhvillimet në Kosovë, Serbi dhe rajonin e gjerë, shpesh të paraqitura në formën e analizave politike ose intervistave me ekspertë.

Një rishikim i disa artikujve të publikuar në këto seksione tregon qartë një paragjykim sistematik dhe një politikë editoriale që përputhet me narrativat zyrtare të qeverisë serbe. Një taktikë e përsëritur është krijimi i një ekuivalence të rreme: analistët serbë që vënë në dyshim legjitimitetin e institucioneve të Kosovës vendosen përballë zërave të përzgjedhur shqiptarë, jo për qëllim të një debati substancial, por për të krijuar iluzionin se “të dy palët” përfaqësohen. Megjithatë, këto opinione nuk vendosen kurrë në një dialog real apo përballje kritike; përkundrazi, ato mbeten paralele, duke krijuar një fasadë neutraliteti, ndërsa në fakt përforcojnë një narrativ të vetme.

Kosovo Online ka qenë aktivisht i përfshirë në mohim të krimeve të luftës të kryera nga Serbia në Kosovë — përfshirë ato të dokumentuara ndërkombëtarisht dhe të cilat mohimi i tyre është kritikuar hapur nga Bashkimi Evropian. Ashtu si qeveria serbe dhe mediat e saj pro-qeveritare, ky medium vazhdon të mohojë masakrën e Reçakut që ka ndodhur më 16 janar 1999 — e cila shënoi përvjetorin e saj të 26-të në fillim të këtij viti.

Me qershor 2025, Zyra e Prokurorit Special të Kosovës njoftoi se mund të ngritë disa aktakuza për krime lufte të kryera gjatë luftës së vitit 1999, përfshirë ato lidhur me ngjarjet e Reçakut. Në këtë kontekst, më 30 qershor 2025, Kosovo Online publikoi një artikull⁴² që vuri në dyshim versionin e pranueshëm ndërkombëtarisht të masakrës, duke promovuar narrativën zyrtare të Serbisë që e paraqet Reçakun si një trillim politik. Artikulli mbështetet në intervista me ish-gjyqtarë serbë si Dragoljub Kojičić dhe Milovan Drecun, të cilët pretendojnë se masakra ishte e inskenuar dhe shërbente si një justifikim për

intervenimin e NATO-s.

Kjo qasje nuk është e izoluar. Pikëpamjet editoriale të Kosovo Online pasqyrohen gjithashtu në seksionin e karikaturave, i cili publikohet rregullisht dhe përdor gjuhë simbolike për të forcuar narrativat anti-Kosovë dhe anti-Perëndimore. Kjo strategji vizuale është një pjesë kyçe e propagandës së këtij mediumi — duke i dhënë mesazheve ideologjike një shtresë ironie ose sarkazmi që i bën ato më të aksesueshme dhe emocionalisht të prekshme për një audiencë më të gjerë

4.2 Dezinformimi që shënjestron komunitetin shqiptar

Komuniteti shqiptar në Kosovë nuk është objektiv i drejtpërdrejtë i dezinformatave të organizuara dhe sistematike që lidhen me marrëdhëniet ndër-etnike. Duke qenë se ky komunitet nuk ka afinitet me narrativat pro-ruse ose pro-serbe, ndjeshmëria e tij ndaj diskursit nacionalist serb mbetet e ulët. Si rezultat, shumica e këtyre narrativave nuk gjejnë jehonë të konsiderueshme në mesin e publikut shqiptar.

Megjithatë, kohët e fundit janë identifikuar përpjekje që synojnë të targetojnë audiencën shqipfolëse përmes formave më të sofistikuar të dezinformatave. Sipas një studimi të publikuar nga Hibrid.info, rrjeti rus i propagandës dhe dezinformatave “Pravda”,⁴³ ka filluar të shënjestrojë në mënyrë specifike opinionin publik shqipfolës në rajon. Hulumtimi, i cili u përqendrua në aktivitetin e këtij rrjeti në Ballkan, tregon se Pravda — e lidhur direkt me Kremlinin — operon përmes faqeve interneti të maskuara si portale lokale lajmesh, duke synuar të manipulojë opinionin publik në nivel global.

Këto faqe interneti, të cilat shfaqen për herë të parë rreth viteve 2013–2014 në Krime dhe Ukrainën Lindore, shpërndajnë narrativa pro-ruse dhe pro-serbe, duke u përqendruar në rajone me lidhje historike ose politike me Rusinë. Një nga shembujt më të spikatur të synimit të audiencës shqipfolëse është portali albania.news-pravda.com. Raporti i Hibrid.info analizon mbi 1,000 artikuj të publikuar midis 28 marsit 2024 dhe 28 prillit 2025, duke dokumentuar strategjitë për ndërtimin e besueshmërisë artificiale, amplifikimin

42 Shih “Rasti Reçakut: A mund të arrihet e vërteta pas Hagës dhe 26 vitesh?” <https://www.kosovo-online.com/en/news/analysis/racak-case-can-truth-be-reached-after-hague-and-26-years-30-6-2025>

43 Gentiana Paçarizi dhe Uran Haxha, Kosovo Online dhe Qeveria Serbe: Një aleancë dezinformatare, Hibrid, qershor 22, 2024, <https://hibrid.info/the-russian-propaganda-network-pravda-and-the-balkans/>

dhe riciklimin e narrativave dezinformuese.

Rrjeti Pravda — i zbuluar fillimisht nga agjencia franceze VIGINUM — operon përmes një infrastrukture të sofistikuar domenesh dhe nëndomenesh të përshtatura për vende të veçanta (p.sh., pravda-xx.com), duke krijuar një pamje besueshmërie lokale. Rrjeti nuk prodhon përmbajtje origjinale; ai mbështetet në shpërndarjen automatike të materialeve nga mediat shtetërore ruse dhe kanalet pro-rusë në Telegram, të cilat përshtaten për audienca specifike bazuar në gjeografi dhe gjuhë.

Ballkani përfaqëson një fokus strategjik për këtë rrjet. Megjithatë rajoni përbën vetëm 3.2% të popullsisë globale, ai absorbon 16.2% të përmbajtjes së shpërndarë nga rrjeti — duke treguar një fokus të qëllimshëm në këtë zonë. Vendet e synuara përfshijnë Serbinë, Bullgarinë, Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, me përmbajtje të përshtatur në gjuhët lokale: serbisht, boshnjakisht, maqedonisht dhe shqip.

Brenda këtij kuadri, albania.news-pravda.com luan një rol kyç në arritjen e audiencës shqipfolëse. Ai publikon në mënyrë të vazhdueshme përmbajtje kritike ndaj NATO-s, BE-së, SHBA-së dhe shtetësisë së Kosovës, duke paraqitur Rusinë si mbrojtëse e “vlerave tradicionale”, një rendi botëror multipolar dhe ligjit ndërkombëtar. Duke u maskuar si një “portal lajmesh”, rrjeti synon të injekttojë narrative të polarizuara dhe të destabilizojë perceptimet publike shqiptare për ngjarjet rajonale dhe globale. Analiza e përmbajtjes së albania.news-pravda.com tregon një orientim të qartë propagandistik me një agjendë rajonale dhe ndërkombëtare. Rreth 64.6% e artikujve fokusohen në çështje ndërkombëtare, 24% në Rusi, dhe vetëm 6.63% në Shqipëri — duke reflektuar një qëllim më të gjerë për të ndikuar perceptimet politike në Ballkan. Artikujt theksojnë narrative pro-Rusi dhe pro-Serbi, lavdërojnë lidhjet ruso-serbe, kritikojnë sanksionet perëndimore dhe paraqesin Kosovën si një burim të vazhdueshëm tensioni dhe jo stabiliteti. Ngjarjet historike si Lufta e Dytë Botërore dhe bombardimet e NATO-s në vitin 1999 përdoren për të forcuar këtë kuadër ideologjik.

Rrjeti Pravda mbështetet gjithashtu në platforma të tilla si Telegram dhe VK (një rrjet social rus). Megjithatë, kanalet e tij në gjuhën shqipe tregojnë angazhim minimal — me vetëm pesë abonentë në Telegram dhe 25 ndjekës në VK deri në prill 2025. Pavarësisht infrastrukturës së tij teknikisht të sofistikuar, ndikimi real i këtij rrjeti në Shqipëri dhe tek folësit e shqipes mbetet i kufizuar.

Megjithatë, pavarësisht këtij depërtimi të kufizuar, rrjeti

shënon një ndryshim të rëndësishëm në strategjinë e propagandës ruse. Ky fakt nënvizon nevojën për një vëmendje më të madhe institucionale dhe mekanizma të fuqishëm rregullatorë. Ndërkohë, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka ndaluar më parë disa media shtetërore ruse pas pushtimit të Ukrainës, megjithatë faqet e tyre të internetit mbeten të aksesueshme herë pas here përmes ofruesve të internetit mobil si Vala, IPKO dhe MTS. Autoriteti Rregullator i Kosovës për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP) ka udhëzuar të gjithë ofruesit e internetit që të bllokojnë këto faqe në përputhje me sanksionet. Megjithatë, natyra fluide e aksesit online bën që zbatimi i ligjit të devijojë.

Përveç përpjekjeve për të manipuluar opinionin publik përmes rrjeteve globale të dezinformimit, fushatat ruse të dezinformimit kanë filluar gjithnjë e më shumë të i targetojnë ata që punojnë për t'i ekspozuar ato - përfshirë verifikuesit e fakteve në Kosovë

Në muajin korrik të vitit 2024, platforma për verifikimin e fakteve Hibrid.info raportoi se ishte bërë objekt i një fushate të koordinuar dezinformatah pro-ruse të quajtur Matryoshka.⁴⁴ pjesë e një operacioni më të gjerë të njohur si Overload. Kjo fushatë synon të dominojë hapësirën mediatike dhe platformat e verifikimit të fakteve duke shpërndarë përmbajtje të fabrikuar, duke promovuar kështu narrativa pro-Kremlinit dhe duke nxitur konfuzion në diskursin publik.

Targetimi përfshin mediat, figura publike, institucione, dhe veçanërisht platformat e verifikimit të fakteve, të cilat mbushen me materiale të rreme të shoqëruara me kërkesa të rreme “qytetare” për verifikim. Kjo simulon shqetësim publik, por në të vërtetë synon të shpërqendrojë gazetaret dhe të amplifikojë përmbajtje pro-ruse në platforma si X (më parë Twitter) duke imituar debat të rregullt publik.

Përmbajtja e përdorur në këtë fushatë imiton identitetin vizual dhe stilin e mediave legjitime, duke mashtruar audiencën që të besojnë se po konsumon informacion të besueshëm. Ajo përfshin video të manipuluar me logot e mediave të vërteta, pamje të rreme të artikujve joekzistentë, dokumente zyrtare të falsifikuara dhe imazhe të dizajnuara për të simuluar “Rrëfimet e Instagramit” nga figura publike. Këto

44 Festim Rizanaj, Matryoshka si Operacion Overload: Një fushatë propaganduese pro-ruse që synon median dhe kontrollues të fakteve, Hibrid, korrik 5, 2024, <https://hibrid.info/matryoshka-si-operacion-overload-nje-fushate-propaganduese-pro-ruse-qe-synon-median-dhe-kontrollues-te-fakteve/>

përdoren për të përhapur narrativa të zakonshme anti-perëndimore dhe anti-Ukrainë: njollosje ndaj refugjatëve ukrainas, tallja e Presidentit Zelensky dhe ushtrisë ukrainase, minimizim të ndihmës ushtarake perëndimore, përqeshje të NATO-s dhe sulme ndaj udhëheqësve perëndimorë.

Brenda kësaj fushate, Hibrid.info u përfshi në një listë me mbi 500 organizata të targetuara rregullisht, së bashku me platforma rajonale si Istinomjer në Bosnjë dhe Vistinomer në Maqedoninë e Veriut. . Në muajt që paraprinin publikimin e raportit, Hibrid mori disa email-e të dyshimta në anglisht nga adresa të paverifikuara të Gmailit, duke kërkuar verifikimin e

grafiteve dhe rrëfimeve të sajura rreth Ukrainës - të gjitha pjesë e kësaj strategjie manipulimi dhe infiltrimi.

Krahës fushatave të organizuara mirë pro-ruse me shtrirje globale, të cilat kanë filluar të targetojnë audiencat që flasin shqip, një fenomen tjetër shqetësues është prania e përmbajtjes në gjuhën shqipe nga media "Kosovo Online." Edhe pse qëllimi i kësaj përfshirjeje mbetet i paqartë, ekspozimi i vazhdueshëm ndaj kësaj përmbajtjeje, sidomos nga qytetarë që nuk kanë aftësi për të vlerësuar burimin dhe besueshmërinë e informacionit, rrezikon të mbjellë konfuzion, të relativizojë të vërtetat historike dhe të thellojë ndarjet në diskursin publik.




FIGURA 4: Modeli i dezinformimit të synuar

4.3 Paraqitja e komunitetit serb në mediat në gjuhën shqip

Edhe pse fushatat e koordinuara të dezinformimit nuk e kanë targetuar drejtpërdrejt komunitetin shqiptar në Kosovë, mënyra se si mediat në gjuhën shqipe raportojnë mbi zhvillimet në veri të Kosovës mund të kontribuojnë në nxitjen e tensioneve ndëretnike. Fokusimi te incidentet, përdorimi i gjuhës së ngarkuar emocionalisht dhe mungesa e zërave të komunitetit serb shpesh prodhojnë një narrativë të pjesshme që përforcon ndarjet ekzistuese. Kjo sugjeron që, edhe pa qenë pjesë e përpjekjeve të orkestruara të propagandës, vetë diskursi i mediave lokale mund të kontribuojë në thellimin e polarizimit shoqëror.

Raportimi mbi komunitetin serb nga mediat shqiptare

zakonisht ndjek tre modele kryesore: fokusin te konflikti dhe kriza, mungesën e përfaqësimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve serbë si burime apo të intervistuar, dhe mbështetjen e madhe te narrativat institucionale. Pjesa më e madhe e mbulimit mediatik lidhet me krizat — tensionet në veri, veprimet e qeverisë për "shtrirjen e sovranitetit," ndërhyrjet policore, deklaratat e Listës Srpska apo përplasjet diplomatike me Serbinë. Kjo qasje e redukton praninë e komunitetit serb në diskursin publik vetëm në një dimension: atë të përballjes politike dhe të sigurisë, duke lënë shumë pak hapësirë për jetën e tyre të përditshme apo për diversitetin e perspektivave.

Në shumë raste, raportimet nuk përfshijnë zëra të drejtpërdrejtë nga qytetarët serbë, as përmes intervistave e as si burime informacioni. Komuniteti shpesh paraqitet si homogjen, pa dallime të brendshme, gjë që çon në përgjithësime të tepërta që

nuk arrijnë të jenë në linjë me realitetin kompleks. Titujt dhe përmbajtja shpesh përdorin gjuhë emocionalisht të ngarkuar për të nxitur frikë, zemërim ose ndjenjë triumfi. Pa analizë kontekstuale, narrativa dominuese priret të nxisë reagime emocionale — qoftë duke amplifikuar perceptimet e kërcënimit, qoftë duke i hedhur poshtë shqetësimet serbe si “propagandë” ose “provokim.” Kjo e bën më të lehtë për publikun shqiptar që t’i refuzojë këto pretendime menjëherë, pa hetime të mëtejshme.

Pjesa më e madhe e përmbajtjes mbështetet në deklaratat nga institucionet e Kosovës — veçanërisht nga qeveria dhe policia — gjë që kufizon aftësinë e mediave për të sfiduar në mënyrë kritike pushtetin ose për të ofruar një pasqyrim më të balancuar që përfshin edhe perspektivat e qytetarëve serbë që mund të mos përfaqësohen nga Lista Srpska. Për më tepër, për shkak të mungesës së raportimit të vazhdueshëm dhe të nuancuar, kur raportohen zhvillimet në veri të Kosovës, komuniteti serb shpesh përshkruhet me terma si “huliganë” ose “instrumente të Serbisë,” duke forcuar stereotipat dhe duke e bërë të pamundur paraqitjen e përfaqësimeve të larmishme ose realiste

4.4 Rasti studimor: Si u prezentua incidenti midis një maturanti serb dhe një zyrtari policor të Kosovës

Më 23 maj, në rrjetet sociale qarkulloi një video që tregonte një grup maturantësh serbë duke parakaluar gjatë festimeve tradicionale të maturës në Mitrovicën e Veriut. Nxënësit, të cilët festonin me fishkëllima dhe brohoritje, thërrisnin slogane si “Kosova është zemra e Serbisë” — gjë që nga komuniteti shqiptar u perceptua si nacionaliste dhe provokuese.

Sipas dëshmitarëve, një qytetar shqiptar, i ulur në një nga kafenetë aty pranë, bëri simbolin e shqiponjës me duar drejtuar kam maturantët — një gjest që shpreh identitetin kombëtar shqiptar dhe që u perceptua si provokim nga maturantët. Si përgjigje, disa prej tyre reagueshan duke bërë gjestin me gishtin e mesit dhe duke ngritur tre gishtat — një shenjë që perceptohet si provokim nga komuniteti shqiptar, pasi gjatë viteve 1990, në kohën e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe luftërave në Bosnje, Kroaci dhe Kosovë, ky gjest u politizua ndjeshëm dhe u bë simbol i nacionalizmit serb, shpesh i lidhur me forcat paramilitare dhe ushtarake që kryen krime lufte në rajon.

Policia e Kosovës ndërhyri menjëherë, duke e larguar njërin nga maturantët nga turma. Një oficer policie i vendosi dorën pas qafës, dhe në pamjet e publikuara u pa një shenjë e kuqe në atë zonë, gjë që ngriti dyshime për përdorim të mundshëm force. Megjithatë, vetë maturanti më vonë deklaroi se shenja ishte bërë me një marker, si pjesë e festimeve të zakonshme të maturës.

Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, deklaroi se maturantët ishin ata që provokuan fillimisht reagimin, ndërsa reagimi i policisë ishte profesional. Nga ana tjetër, maturantët pohuan se ata kishin reaguar vetëm pasi qytetari në kafene kishte bërë gjestin e shqiponjës.

Reagimet zyrtare nuk munguan. Ministria e Jashtme serbe dënoi ashpër ndërhyrjen e policisë dhe kërkoi ndjekje penale të oficerit të policisë së përfshirë. Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) lëshoi një deklaratë publike duke vlerësuar se Policia e Kosovës mund të ketë përdorur forcë të tepërt në këtë rast. Ndërkohë, Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës njoftoi se oficeri i policisë është transferuar në pjesën jugore të Mitrovicës për arsye sigurie dhe se rasti i është referuar Inspektoratit të Policisë së Kosovës për hetime të mëtejshme.

Ngjarja nxiti një debat të gjerë në media, me narrativa të ndryshme që qarkullonin rreth asaj se kush ishte përgjegjës për incidentin.

Disa tabloide dhe portale serbe e përqendruan raportimin e tyre. ⁴⁵ te shenjat e dukshme të kuqe në qafën e maturantit gjatë incidentit, duke pretenduar se policia i kishte shkaktuar atij lëndime fizike. Titujt e tyre theksonin se policia e kishte “gjakosur” maturantin. Për shembull, tabloidi Alo publikoi titullin: “Tmerr në Mitrovicën e Kosovës! Policia e Kurtit sulmon maturantin, gjak kudo, e kapën për fyt!” Ndërsa portali Direktno shkroi: “Incident në Mitrovicën e Kosovës: Policia e Kosovës keqtrajton maturantin, qafa E MBULUAR ME GJAK,” duke e përsëritur të njëjtin pretendim edhe në përmbajtjen e artikullit. Edhe portali Insajder raportoi për “gjurmë të dukshme gjaku” në qafën e maturantit, duke cituar KoSSev dhe FoNet — megjithëse KoSSev nuk kishte raportuar asnjë detaj të tillë..

Kanalet në gjuhën serbe në Telegram gjithashtu instrumentalizuan këtë incident. Përmbajtja e

45 KosSev, “Policia, Provokimi dhe një ‘Qafë e Përgjakshme’ që nuk ishte”, 4 qershor 2025, <https://kossev.info/police-provocation-and-a-bloody-neck-that-wasn-t/>

analizuar ndjek një strukturë të përsëritur komunikimi, e përdorur zakonisht nga shumë prej këtyre kanaleve për të shfrytëzuar zhvillime të ngjashme në Kosovë: ndërtimi i një narrative që zhvillohet në tre etapa — alarm, viktimizim dhe heroizim. Ky hark narrativ synon të mobilizojë emocionet, të nxisë tensionet ndëretnike dhe të përforcojë një identitet politik të rrënjosur në përjashtim dhe konflikt.

FAZA E PARË: Alarm dhe Panikë

Narrativa fillon me përhapjen e menjëhershme dhe të dramatizuar të incidentit me nxënësin serb të shkollës së mesme në Mitrovicë. Ngjarja paraqitet si një akt dhune brutale nga një "terrorist shqiptar me uniformë," me theks jo te mungesa e profesionalizmit të policit, por te përkatësia e tij etnike. Lajmi qarkullon me tone të larta emocionale: përshkruhen lëndime të dukshme, përdoren shprehje si "turma shqiptare," dhe përdoren simbole që synojnë të nxisin frikë kolektive. Edhe kur publikohet pamja me video, ato nxirren nga konteksti për të përforcuar narrativën e agresionit të paprovokuar. Në këtë fazë, çdo veprim nga pala shqiptare paraqitet si agresion, ndërsa çdo reagim nga pala serbe si mbrojtje. Këtu fillon edhe delegjitimimi institucional — shteti dhe Policia e Kosovës quhen "të ashtuquajtura," duke mohuar legjitimitetin e tyre.

FAZA E DYTË: Viktimizimi kolektiv dhe thirrja për mobilizim

Pasi publikut iu është shfaqur incidenti përmes imazheve dhe tregimeve emocionale, narrativa kalon në një fazë më të thellë viktimizimi. Maturanti përfaqëson të gjithë serbët në Kosovë që vuajnë "vetëm se janë serbë." Përmendet provokimi nga qytetari shqiptar në kafene, dhe kritikohet heshitja e autoriteteve ndërkombëtare. Kjo fazë shfaq një ndjenjë fataliteti historik: popullsia serbe paraqitet si e shtypur, por e pathyeshme, ndërsa çdo institucion që dështon të reagojë konsiderohet si bashkëfajtor në padrejtësi. Figura biblike dhe patriotike përdoren për të aktivizuar kujtesën kolektive të sakrificës dhe martirizimit.

FAZA E TRETË: Heroizimi dhe hakmarrja simbolike

Në kulmin e emocioneve, narrativa kalon në fazën e heroizimit të maturantit, nga viktimë në martir

kombëtar. Solidariteti shprehet përmes gjesteve simbolike, siç janë nxënësit në Beograd që vendosin bojë të kuqe në qafë në shenjë solidariteti, recitimi i poezive nacionaliste për maturantit, ose imazhet e tij të shoqëruara me zëra të këngëve nacionaliste, ndërkohë që polici shqiptar identifikohet publikisht dhe poshtërohet si "armik." Urdhri i arrestit i lëshuar nga Ministria e Brendshme e Serbisë paraqitet si një akt drejtësie kombëtare, i cili synon jo vetëm ndëshkimin e individit, por edhe rikthimin moral të kontrollit serb mbi Kosovën. Kjo fazë mbyllet me thirrje për rezistencë dhe premtime për "çlirimin e ardhshëm," duke e kurorëzuar narrativën me një akt simbolik të hakmarrjes së vonuar.

Aspekti kritik i këtij instrumentalizimi është shmangia e qëllimshme e fakteve që do ta sfidonin narrativën e viktimizimit. Kanale të Telegram-it që promovuan narrativën e "torturës" dhe "dhunës brutale" ose e injoruan, ose e shtrembëruan me qëllim faktin publikisht të konfirmuar se shenjat e kuqe në qafën e maturantit ishin shkaktuar nga boja e markerit e përdorur gjatë festimeve të maturës. Ky fakt u konfirmua si nga vetë maturantët, ashtu edhe nga drejtori i Policisë së Kosovës, bazuar në deklaratat e nxënësve të përfshirë. Dështimi për ta raportuar këtë informacion ose shtrembërimi i tij tregon se qëllimi i këtyre kanaleve nuk është informimi, por ruajtja e një narrative të përzgjedhur që i shërben qëllimeve propagandistike. Kjo është një strategji klasike e dezinformimit: përzgjedhja selektive e fakteve për të ndërtuar një realitet të ngarkuar emocionalisht, por faktikisht të shtrembëruar.

Si raportuan mediat shqiptare?

Shumica e mediave në gjuhën shqipe e mbuluan incidentin në Mitrovicën e Veriut përmes një kuadri institucional që legjitimoi veprimin e policisë dhe e paraqiti ngjarjen si një provokim të inskenuar nga Serbia. Kjo qasje e theksoi luftën kundër propagandës, por rrallëherë u shoqërua me hulumtime të pavarura ose narrativa alternative, duke rrezikuar që vetë diskursi mediatik të kontribuonte në polarizim.

Korniza Institucionale dhe Interpretimi Zyrtar i Ngjarjes

Mediat shqiptare e mbuluan incidentin në Mitrovicën e Veriut përmes një kornize institucionale, duke u mbështetur kryesisht në deklaratat zyrtare nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ministri Xhelal

Sveçla theksoi se Policia e Kosovës kishte vepruar në mënyrë profesionale, duke ndërhyrë për të parandaluar përshkallëzimin pas thirrjeve nacionaliste dhe përdorimit të simboleve provokuese nga disa maturantë serbë. Thirrjet si “Kosova është zemra e Serbisë” dhe përdorimi i simbolit me tre gishta u përshkruan si fyerje ndaj viktimave të luftës dhe si një rikthim i pretendimeve territoriale të Serbisë. Kjo kornizë synonte të legjitimonte ndërhyrjen e policisë dhe të vendoste një vijë të qartë ndarëse midis “provokatorëve” dhe sundimit të ligjit.

Paraqitja e pretendimeve të serbëve të Kosovës si propagandistë dhe i Incidentit si një ngjarje e inskenuar

Narrativat që u shfaqën në raportimin mediatik në Kosovë lidhur me incidentin në Mitrovicën e Veriut u përqendruan rreth idesë se ngjarja ishte e inskenuar, pjesë e një strategjie më të gjerë propagandistike të orkestruar nga Serbia. Sipas kësaj interpretimi, qëllimi ishte diskreditimi i institucioneve të Kosovës në veri dhe rikthimi i ndikimit serb në atë zonë. Titujt, të ftuarit dhe fokusi i raportimeve mediatike theksuan mohimin institucional të çdo përdorimi të dhunës nga autoritetet vendore, duke e paraqitur incidentin si produkt të propagandës. Disa media përdorën drejtpërdrejt termin “ngjarje e inskenuar” për të delegitimuar pretendimet serbe. Ndaras nga kjo, të tjerët sugjeruan se Serbia po instrumentalizon të rinjtë për të nxitur tensione dhe trazira në veri të Kosovës.

Deklaratat e analistëve dhe zyrtarëve e përforcuan këtë qëndrim, duke e përshkruar incidentin si një manovër të qëllimshme që synonte portretizimin e Kosovës si një shtet represiv në sytë e bashkësisë ndërkombëtare. Akuzat për dhunë ndaj maturantëve u hodhën poshtë. Njëkohësisht, ngjarja u definua si pjesë e një “lufte hibride” që shfrytëzon ndjeshmëritë etnike dhe perceptimet ndërkombëtare për të ndërtuar një imazh të rremë të realitetit në Kosovë.

Raportimet nuk u ndalën vetëm te rasti i maturantit, por paralajmëruan edhe për mundësinë e inskenimeve të tjera të ngjashme nga Serbia. Këto u trajtuan si pjesë e një diplomacie të rreme dhe e një strategjie më të gjerë për destabilizim. Në këtë kontekst, mesazhi i përcjellur ishte ai i rritjes së vigjilencës institucionale dhe nevojës për të ruajtur rendin dhe ligjin në pjesën veriore të vendit, duke shmangur çdo përfshirje në kurthet propagandistike që synojnë minimin e sovranitetit të Kosovës.

Mungesa e hulumtimit përtej versionit institucional

Pavarësisht jehonës që pati incidenti, raportimi nga shumica e mediave shqiptare mbeti brenda versionit zyrtar, pa ndjekur kërkime të pavarura ose rrëfime alternative nga qytetarët, organizatat për të drejtat e njeriut apo vetë pjesëmarrësit. Aspektet e ndjeshme – si përfshirja e një të mituri në incident, përdorimi i forcës policore ose trajtimi i simbolikës në kontekst të ndjeshmërisë etnike – u raportuan në mënyrë sipërfaqësore. Në mungesë të një qasjeje hetimore, mediat lokale humbën mundësinë për të analizuar incidentin më thellësisht, duke reduktuar kështu hapësirën për reflektim kritik mbi praktikën policore në veri dhe menaxhimin institucional të tensioneve ndëretnike.

Edhe pse disa kryetituj përmendën “incident të inskenuar” ose “reagime të ashpra”, asnjë titull nuk eksplori në mënyrë të pavarur përvojat e të rinjve në terren, dëshmitarëve okularë ose verifikimin e pavarur vizual/ forenzik (siç është burimi i njollave të kuqe). Kjo mungesë konfirmon mbështetjen në deklaratat zyrtare, siç u identifikua në pikën e tretë të analizës.

Instrumentalizimi i incidentit me nxënësin serb të shkollës së mesme në Mitrovicë, si nga kanalet në gjuhën serbe në Telegram, ashtu edhe nga një pjesë e medias shqiptare, edhe pse nuk është i një natyre të njëjtë, rëndon diskursin ndëretnik dhe e bën më të vështirë adresimin e ndjeshmërive reale në terren. Në rastin e Telegramit, ngjarja u përdor për të prodhuar një narrative të qëllimshme të viktimizimit, e cila shërben për mobilizim politik dhe nacionalist. Ndërkohë, shumë media shqiptare u fokusuan në interpretimin institucional të incidentit, duke e paraqitur atë si një inskenim propagandistik nga Serbia dhe duke delegitimuar që në fillim mundësinë që nxënësi i shkollës së mesme të kishte përjetuar ndonjë trajtim të papërshtatshëm.

Kjo qasje me dy drejtime rrezikon thellimin e ndarjes ndëretnike: nga njëra anë, komuniteti serb e sheh mungesën e përfaqësimit në media si provë të përjashtimit sistematik; nga ana tjetër, komuniteti shqiptar ndikohet nga një diskurs që minimizon çdo reagim nga komuniteti serb si propagandë. Si rezultat, shqetësimet legjitime të individëve serb që jetojnë në Kosovë, qofshin ato në lidhje me sigurinë, përfaqësimin apo tensionet e përditshme, injorohen ose relativizohen, duke krijuar një mjedis ku edhe zërat e arsyeshëm mbyten nga zhurma e narrativave të polarizuara. Kjo e bën më të vështirë ndërtimin e një diskursi gjithëpërfshirës dhe konstruktiv që trajton në mënyrë reale sfidat ndëretnike.

5. Konkluzione dhe Rekomandimet

Ky raport ka treguar se narrativat e dezinformatave në Kosovë, qoftë të nxitura nga aktorë të huaj, vendas apo hibridë, nuk përhapin vetëm gënjeshtria; ato synojnë të ndërtojnë/forma realitete alternative, ose "fakte alternative," të rregulluara me kujdes sipas frikave më të thella të secilës audiencë. Për serbët e Kosovës, kjo do të thotë një ekspozim i vazhdueshëm ndaj rrëfimeve që i portretizojnë institucionet e Kosovës si një kërcënim ekzistencial, si jo-legjitime, dhe komunitetin ndërkombëtar, BE-në, si bashkëfajtor në viktimizimin e tyre. Për shqiptarët e Kosovës, është një ritëm i vazhdueshëm paralajmërimesh mbi agresionin serb, fantazmën e humbjes territoriale dhe tradhtinë e idealeve kombëtare përmes dialogut të normalizimit. Këto narrative janë asimetrike, por ato përforcojnë reciprokisht njëra-tjetrën, duke u përpjekur të erodojnë empatinë dhe besimin.

Provat sugjerojnë se dezinformimi shpesh është më shumë një rezultat sesa një përshpejtues i tensioneve ndëretnike. Ajo lulëzon në momente krize politike, siç është mosmarrëveshja për targat me Serbinë, zgjedhjet lokale në veri ose incidente të tjera të dhunshme. Ai i riformulon ato përmes një cikli alarmi, viktimizimi dhe heroizimi. Rasti i përplasjes gjatë festimit të diplomimit në Mitrovicë është simbolik; një incident i vogël u transformua në një pikë tubimi nacionalist në kanalet serbe të Telegramit kurse në mediat shqipe si një provokim të inskenuar. Asnjëra palë nuk e vuri në dyshim narrativën e vet, dhe e vërteta u varros nën shtresa të interpretimit emocional dhe etnocentrik.

Ajo që del nga hartëzimi është një pamje e një ekosistemi shumë adaptues. Mediat pro-qeveritare serbe, si Kosovo Online, i japin propagandës peshë institucionale, ndërsa rrjetet e pa-moderuara në Telegram shpërndajnë përmbajtjen më ekstreme, nga memet që lavdërojnë luftën deri te thirrjet për mobilizim. Mediat në gjuhën shqipe në Kosovë, edhe pse nuk marrin pjesë në propagandë të koordinuar, shpesh bien në modele të raportimit njëanshëm, mbështetjes së tepruar tek burimet zyrtare dhe mungesë pothuajse totale të zërave të serbëve të Kosovës. Kjo arkitekturë paralele e informacionit, e ndarë sipas gjuhës dhe politikës, ndihmon në ruajtjen e ndarjes midis dy komuniteteve që jetojnë në realitete të ndara.

Efeti i akumuluar është një klimë para-radikalizimi, ku mënyra e të menduarit të gjitha ose asgjë bëhet standardi. Hartimi i narrativave tregon se çdo rrjedhë ngjarjesh, sado e vogël, në fund formësohet nga një kornizë e vetme: ne jemi të mirë, ata janë të këqij. Kur ky mendim me dy tyta normalizohet, aktorët politikë mund të mobilizojnë më lehtë sentimentin publik kundër dialogut të normalizimit të udhëhequr nga BE-ja, marrëveshjeve dhe zbatimit të tyre, madje edhe kundër bashkëjetesës bazike. Atëherë në fakt disinformimi kalon nga një problem komunikimi në një kërcënim strukturor për stabilitetin dhe funksionimin demokratik të Kosovës.

Ndikimi i huaj, veçanërisht nga Serbia dhe Rusia, e shfrytëzon në mënyrë aktive këtë mjedis me saktësi. Por problemi nuk importohet i tërë.. Aktorët vendas, nga partitë politike te mediat sensacionale, riciklojnë dhe përshtatin këto narrative kur u shërben agjendës së tyre. Duke vepruar kështu, ata normalizojnë vetë logjikën e ndarjes mbi të cilën mbështeten aktorët e huaj. Qështja bëhet serioze kur zyrtarë të lartë dhe të nivelit të lartë qeveritar angazhohen në përhapjen e gjysmë të vërtetave dhe dezinformatave, veçanërisht lidhur me dialogun e normalizimit dhe gjendjen e marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë. Nëse lihet pa kontroll, dezinformimi në Kosovë do të forcojë murin mes shqiptarëve dhe serbëve dhe do ta bëjë dialogun e normalizimit ose çdo përpjekje për pajtim dhe normalizim jo vetëm të vështirë, por të parëndësishme. Bazuar në këtë, rekomandimet e mëposhtme duhet të merren parasysh nga aktorët përkatës të adresuar te:

- ▶ Qeveria e Kosovës duhet të ndajë fonde për organizatat e pavarura të verifikimit të fakteve për të mbështetur punën e tyre dhe të krijojë njësi të dedikuara që monitorojnë dhe demaskojnë dezinformimin mbi integrimin e Kosovës në BE, dialogun Kosovë–Serbi, dhe çështje të tjera me interes kombëtar. Këto mekanizma duhet të mbeten jashtë kontrollit të drejtpërdrejtë qeveritar për të shmangur politizimin dhe keqpërdorimin. Në të njëjtën kohë, mbështetja e qeverisë nuk duhet të jetë e dizajnuar në një kuadër mono-etnik. Duke qenë se si komuniteti shqiptar ashtu edhe

ai serb në Kosovë janë objekt i dezinformimit ose i narrativave të njëanshme, shpërndarja e fondeve duhet të kërkojë që iniciativat e verifikimit të fakteve të funksionojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të adresojnë narrativat në të gjitha linjat gjuhësore dhe komuniteteve.

- Organizatat e shoqërisë civile dhe ato të verifikimit të fakteve në Kosovë duhet të dizajnojnë iniciativa kundër dezinformimit që të jenë multietnike në përmbajtje dhe dygjuhësore në rezultat. Verifikuesit e fakteve duhet të monitorojnë dhe të demaskojnë sistematikisht pretendimet e rreme që qarkullojnë në mediat shqipe dhe serbe, duke siguruar që gjetjet e tyre të jenë të aksesueshme për të dy komunitetet. Ky qasje e balancuar do të zvogëlojë perceptimet e paragjykimit, do të nxisë besim më të madh publik dhe do të demonstrojë se dezinformimi dëmton të drejtat dhe interesat e të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga përkatësia etnike.
- Qeveria e Kosovës duhet të rishikojë strategjinë kombëtare të sigurisë për të integruar masa kundër dezinformimit. Strategjia aktuale e Sigurisë e Kosovës 2022–2027⁴⁶ përmend dezinformimin vetëm një herë dhe keqinformimin dy herë. Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2023–2027⁴⁷ e përmend dezinformimin më mirë, por mungon përfshirja e tij si një objektiv strategjik i veçantë, gjë që duhet të jetë. Agjencia relativisht rishtazi e themeluar për Sigurinë Kibernetike duhet të mbështetet për të pasur një njësi të dedikuar dhe kapacitete për të kundërshtuar dezinformimin.
- Kryeministri i Kosovës duhet të emërojë një serb të Kosovës si një nga zëdhënësit e qeverisë dhe gjithashtu të kërkojë që të gjitha ministritë të kenë një zëdhënës të dedikuar në gjuhën serbe i cili angazhohet në mënyrë proaktive me mediat në gjuhën serbe në Kosovë.
- Asociacioni i Komunave të Kosovës duhet të rrisë mbështetjen për zhvillimin e kapaciteteve për komunat, përkatësisht njësitë komunale,

për informimin publik, për dezinformimin dhe sigurinë kibernetike, si dhe për ngritjen e ekipeve të komunikimit në kriza në nivel komunal të trajnuara për të reaguar shpejt gjatë incidenteve ndëretnike, me fokus në saktësi, dygjuhësi dhe neutralitet. Kjo duhet të prioritetizohet, veçanërisht për komunat multietnike. Asociacioni i Komunave të Kosovës duhet të punojë së bashku me shoqërinë civile për të organizuar punëtori të bazuara në komunitet për verifikimin e fakteve, duke pajisur udhëheqësit lokalë dhe aktivistët me aftësitë për të identifikuar dhe kundërshtuar pretendime të rreme që qarkullojnë në mediat sociale. Edhe një here, kjo duhet të prioritetizohet, veçanërisht në komunat multietnike.

- Shoqëria civile në Kosovë, ose Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, duhet të konsiderojë krijimin e një koalicioni të përbashkët monitorimi mediatik online për mediat shqipe dhe serbe, i cili të ndjekë dhe raportojë publikisht trendet e dezinformimit në të dy hapësirat gjuhësore, duke siguruar që gjetjet të jenë të aksesueshme në të dy komunitetet. Diçka e ngjashme me Disinformation Hub ekziston në nivel rajonal, por mund të jetë më e fokusuar dhe më aktive për rastin e Kosovës. Organizatat e shoqërisë civile duhet gjithashtu të angazhohen më aktivisht në iniciativa për ndërtimin e narrativave që prodhojnë dhe promovojnë histori alternative bashkëpunimi, jetës së përditshme dhe sfidave të përbashkëta, duke përdorur formate që mund të konkurrojnë në të njëjtat hapësira online ku qarkullon dezinformimi.
- Organizatat mediatike në Kosovë duhet të zbatojnë standarde editoriale që kërkojnë burime nga komunitete të ndryshme në çdo raport mbi çështjet ndëretnike, duke shmangur mbështetjen vetëm në deklarata zyrtare, dhe duhet të investojnë në kapacitetet për verifikimin e fakteve. Për më tepër, mediat duhet të shmangin paraqitjen e ngjarjeve si “ngjarje të inskenuara” pa verifikim, dhe çdo pretendim për orkestrim apo provokim duhet të mbështetet plotësisht në dëshmi, jo në përfundime politike. Për më tepër, është thelbësore që në publikime të bëhet dallimi i qartë midis opinionit dhe faktit.

46 <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/10/2-Strategjia-e-Sigurise-e-Kosoves-ENG.pdf>

47 <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/2692/Strategjia%20p%C3%ABr%20Siguri%20Kibernetike%20-%20ENG.pdf>

SI E NXIT DEZINFORMIMI RADIKALIZIMIN ETNO-POLITIK NË KOSOVË

Botuar nga:



© Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS)

Dizajni dhe faqosja nga:

Brand Vision Shpk

Kontakti: +383 45 559 923

Email: brandvision.rks@gmail.com

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

659.3(496.51)(047)

Paçarizi, Gentiana

How Disinformation Fuels Ethno-Political Radicalization in Kosovo /
Gentiana Paçarizi, Ramadan Ilazi, Pia-K. Pallasch. – Prishtinë : QKSS, 2025. – 43 f. : ilustr. ; 28 cm.

1. Ilazi, Ramadan 2. Pallasch, Pia-K.

ISBN 978-9951-842-50-1



QKSS
Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

17
VITE

Rreth QKSS

E themeluar në prill të vitit 2008, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) është një organizatë e specializuar dhe e pavarur joqeveritare. Qëllimi primar i QKSS është të promovojë demokratizimin e sektorit të sigurisë në Kosovë dhe të përmirësojë punën kërkimore dhe avokuese në lidhje me sigurinë, sundimin e ligjit dhe bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e sigurisë.

QKSS synon të rrisë efektivitetin e Reformës së Sektorit të Sigurisë duke mbështetur programet e këtij sektori përmes hulumtimeve, eventeve, trajnimeve, avokimit dhe këshillave të drejtpërdrejta për politikë-bërësit.

Avancimi i ideve të reja dhe metodave të shkencave sociale janë gjithashtu vlerat thelbësore të qendrës. Çdo vit, QKSS publikon raporte të shumta, analiza të politikave dhe përmbledhje të politikave për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë. QKSS gjithashtu organizon më shumë se 200 ngjarje publike duke përfshirë konferenca, tryeza dhe debate, ligjërata në Kosovë, ku një pjesë e tyre organizohen në bashkëpunim me partnerë rajonalë dhe ndërkombëtarë.

Një gamë e gjerë aktiviteteve përfshijnë hulumtimin, ngritjen e kapaciteteve, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe avokimin. Puna e QKSS-së mbulon një gamë të gjerë temash, duke përfshirë por pa u kufizuar në: reformën dhe zhvillimin e sektorit të sigurisë, identifikimin dhe analizimin e rreziqeve të sigurisë që lidhen me ekstremizmin, radikalizmin dhe krimin e organizuar, politikën e jashtme dhe bashkëpunimi rajonal, dhe vlerësimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Për më tepër detaje rreth QKSS, ju lutem na ndiqni në rrjetet tona sociale:



qkss.org
securitybarometer.qkss.org



@KCSSQKSS
#KCSSQKSS

ISBN 978-9951-842-50-1



9 789951 842501